

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E HËNË 3 TETOR 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Në fakt, shqetësimi më i madh, që unë mendoja se kjo sallë meritonte të diskutonte sot nga shumica do të ishte peticioni i dërguar nga sindikata e pedagogëve të Shqipërisë drejtuar institucioneve, sepse shtresa më intelektuale e vendit prej javësh proteston dhe, nga ana tjetër, në datën 5 ata kanë paralajmëruar protestën e radhës dhe përshkallëzimin e saj. Pa dyshim, në qoftë se konsultohemi se çfarë kërkojnë pedagogët e universiteteve të Shqipërisë, ata kërkojnë pagë sa Kosova. Ata nuk kërkojnë rrogë sa Mali i zi, as sa Kroacia dhe të mos flasim për vendet europiane, por kërkojnë një pagë dinjitoze sa Kosova.

Imagjinoni sa të keqpaguar janë pedagogët e mësuesit në këtë vend dhe më pas të flasim për cilësinë në arsim apo prioritet arsimin! Çfarë kërkojnë tjetër pedagogët?! Ata kërkojnë rritje të buxhetit për kërkimin shkencor, i cili sot është 0,1% e GDP-së dhe kërkojnë ta çojnë në 0,3% , por në momentin që kjo qeveri zhvillimin e sheh te krimi dhe jo tek arsimi, pa dyshim që nuk më bën habi ky injorim i kërkesave të tyre apo mosplotësimi i tyre. E kam thënë në këtë sallë, sepse kjo maxhorancë ka folur me fakte kur është folur për buxhetin e arsimit dhe në aktin normativ të parë që solli në muajin mars për paketën e rezistencës, të parin që preku ishte buxheti në arsim, me 15 milionë dollarë, ndërkohë, para disa javësh Banka Botërore del me një deklaratë, e cila shpreh shumë qartë që nuk sugjerohet dhe nuk këshillohet prekja e dy buxheteve në këto kohë krizash: buxheti i arsimit dhe buxheti i shëndetësisë.

Banka Botërore thotë shprehimisht: “Të mos shkurtohen fondet për arsimin dhe shëndetësinë, pasi ato vlerësohen me pamjaftueshmëri të thellë, në raport me nevojat reale që ata kanë”, ndërkohë ne shkurtojmë buxhetin e arsimit në të parin akt normativ që sjellim këtu. Të mos ndalem te mbyllja e një shkolle, e cila ka 20 vjet që punon në Shqipëri. Këtu, me të drejtë, ministrja e Arsimit tha se ka shkelje të këtyre pronarëve në të gjithë administrimin e këtij biznesi e me radhë. Më lejoni t’ju citoj raportin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, i cili merret të

drejtat e njeriut dhe zbatimin e ligjit: “Procedurat autoritare për mbylljen e kolegjit turk “Mehmet Akif” nuk përmbushin standardet e procesit të rregullt ligjor dhe rezultojnë me dhënien e një mase të ashpër, të nxituar, jo proporcionale dhe me pasoja të dëmshme.

Në VKM-në e datës 22.09.2022 kjo qeveri nuk ka argumentuar asnjë arsye apo motiv konkret se ku janë shkeljet që prezumohen të jenë bërë, pra shkeljet e ligjit që kanë kushtëzuar mbylljen e kësaj shkolle, përkundrazi aty janë dhënë vetëm detyrimet e institucioneve paraarsimore. Kjo duke shkelur vendimet e Gjykatës Kushtetuese apo praktika të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut. Këto i thotë Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Procesi i rregullt ligjor nuk është vetëm procesi gjyqësor, por edhe procesi administrativ, si reagon ti me subjekte të caktuara. Nuk është dhënë asnjë paralajmërim, asnjë gjobë dhe më pas të shkonte në heqje licence. Këtë e thotë shumë qartë në analizën shteruese raporti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Pa dyshim që raporti i KLSH-së për qendrën “Zyber Halluli” ishte tronditës dhe nuk ishte propagandë e opozitës, siç u tha këtu, por ishin mediet ato që ngritën zërin për këtë problematikë madhore të raportit të KLSH-së. Çfarë kërkova unë?! I kam kërkuar Kryetares së Kuvendit, si nënkryetare e grupit të deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” që t’i sqarojmë të gjitha këto problematika, sepse u mohohet dhe u ulët sasia e vakteve këtyre fëmijëve. Llogaridhënia nuk është arrogancë, përkundrazi është transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve, mbi të gjitha. Mendoj se ky rast skandaloz i abuzimeve me fondet publike në një qendër, e cila duhet të jetë përgjegjësia e të gjithëve ne për t’u kujdesur për të, kërkon transparencë.

Ndaj, të bëhet edhe mbledhja e këtij grupimi, në mënyrë që KLSH-ja dhe institucionet përgjegjëse për mbarëvajtjen e atij institucioni të raportojnë se çfarë ka ndodhur dhe çfarë ndodh në këto qendra të kujdesit ndaj fëmijëve. Të abuzosh me bukën e fëmijëve, pa dyshim, është rëndë dhe, pa dyshim që të gjithë tronditemi, por kjo kërkesë llogarie mendoj se i shërben të mirës publike. Nga ana tjetër, mendoj se një nga problematikat, që duhet të na shqetësojë të gjithë, është se arsimin duhet ta kthejmë në prioritet kombëtar. Kjo është e vetmja mënyrë për të pasur mundësi që këta të rinj të mos largohen nga vendi, që këta të rinj të kenë një arsim cilësor, që këta mësues dhe pedagogë të kenë një pagë dinjitoze sa Kosova, nuk po kërkojnë sa vendet e tjera europiane.

Në qoftë se vërtet e kemi arsimin prioritet, do të duhet ta buxhetojmë e ta financojmë, përndryshe drama që po u bëhet të rinjve dhe vendit, do të ndihet shumë në vitet që vijnë, sepse zhvillimi nuk mund të vijë, absolutisht nga krimi, por vetëm nga një edukim cilësor. Faleminderit!